



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Komuna e Prishtinës

Kryetari i Komunës

01. nr. 465-306709 më 19. 12. 2016

Në bazë të dispozitave të nenit 4 dhe dispozitave të nenit 10 të Ligjit nr. 03 / L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 91), të dispozitave të neneve: 11, 82 dhe 109 të Ligjit nr. 02/L-28, për Procedurën Administrative, i fuqizuar me Rregulloren nr. 2006/33, të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dispozitave të Vendimit për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale, të dt. 20.04.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr:

## V E N D I M P R E L I M I N A R

I. **MIRATOHET** shpronësimi i parcelës kadastrale nr. 4373-1 me sipërfaqe prej 507 m<sup>2</sup>, e cila shtrihet në Zonën Kadastrale Prishtinë në pronësi të Ruzhdi (Maliq) Kryeziu sipas listës së bashkangjitur këtij Vendimi, për arritjen e qëllimit dhe përfitimit të ligjshëm publik, ku sipas projektit të Komunës së Prishtinës është paraparë realizimi i projektit të ndërtimit të “Shkollës faza II” në lagjen “Arbëria” .

II. Obligohet Drejtoria e Pronës ti dërgojë Vendimin Preliminar personave të identifikuar në kërkesë, brenda pesë (5) ditëve të punës.

III. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Preliminar, Drejtoria e Pronës e shpall Vendimin në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Faqe 1 nga 2

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë

Telefon: + 381(0)38/230-900

<http://www.prishtina-komuna.org>

IV. Kundër këtij Vendimi apo cilëso pjesë të tij brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi ka të drejtë të paraqesë ankesë në Gjykatën Themelore Prishtinë çdo person i cili është Pronar ose Zotërues i Interesit në pronën e prekur nga Vendimi, dhe i cili ka arsye të mira për të besuar se Vendimi Preliminar është në kundërshtim me një ose më shumë kushte të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4 ,në përputhje me nenin 35 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr.03/L-139,me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 91) .

V. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria e Pronës, Drejtoria e Kadastrit, Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Infrastrukturës Lokale.

VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërin nga gazetatat me tirazh të madh.

VII. Pjesë e këtij Vendimi është Lista e përshkrimit detaj të parcelës kadastrale nga pika I e këtij Vendimi.

Iu dërgohet:

- të gjitha Drejtorive dhe
- në Dosje.



Kryetari i Komunës  
Shpend Ahmeti

Faqe 2 nga 2